



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KOMERCIALE**

---

Numri i lëndës: 2023:168247

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05362677

KPPP.nr. 1233/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, gjyqtari Florent Zeqiri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “Triangle” Sh.P.K., me numër të regjistrimit të biznesit 810048167, me seli në Suharekë, rr. “Brigada 123”, p.n., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson L.B., avokat nga Suhareka, kundër debitorit Kuvendi Komunal Prizren, me seli në Prizren, rr. “Remzi Ademaj”, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr. 356/2023 i datës 20.07.2023, të lejuar nga Përmbartuesi Privat Liridon H. Tërshani nga Prizreni, jashtë seancës me datën 22.02.2024, merr këtë:

**A K T V E N D I M**

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Kuvendi Komunal Prizren, ndërsa Urdhri Përmbartimor P.nr. 356/2023 i datës 20.07.2023, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Liridon H. Tërshani, MBETET NË FUQI.
- II. OBLIGOHET debitori, që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim, t’ia paguaj kreditorit shumën prej EUR 208.00 (me shkronja: dyqind e tetë euro), në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

**A r s y e t i m**

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit “Triangle” Sh.P.K., me datë 20.07.2023 ka lëshuar urdhrin P.nr. 356/2023, duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit Faturë nr. 013/23, e datës 15.06.2023, me të cilin e ka urdhëruar debitorin që në emër të borxhit të përcaktuar sipas faturës së lartcekur t’ia paguaj kreditorit shumën prej 21,498.00 EUR (me

shkronja: njëzet e një mijë e katërqind e nëntëdhjetë e tetë euro), me kamatë ligjore prej 8 % nga data e arritshmërisë për pagesë, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori brenda afatit ligjor ka parashtruar Prapësim duke kundërshtuar në tërësi Urdhrin Përmbartimor, me arsyetimin se Përmbartuesi në bazë të urdhrit ka vepruar në kundërshtim me nenin 29, par. 1 të LPP-së, pasi që propozimi i tillë nuk është i përshtatshëm për përmbartim sepse nuk i'a ka bashkangjitur faturën, e njëjta nuk ekziston si provë për të dëshmuar se ekziston një dokument i rregullt përmbartimor. I ka propozuar gjykatës që të aprovojë prapësimin e debitorit si të bazuar, ashtu që propozimin për përmbartim ta refuzojë dhe të anulohet urdhri përmbartimor.

Kreditori në përgjigje në prapësim ka theksuar se nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sa i përket asaj që kreditori nuk ka prova që debitori ka borxh ndaj tij, i cili arsyetim është për t'i ikur obligimeve që ka ndaj kreditorit, si dhe që në propozimin për përmbartim nuk ka bashkangjitur faturën më të cilën është lejuar urdhri përmbartimor, e që të njëjtën e ka dorëzuar edhe tek debitori. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë prapësimin e debitorit si të pa bazuar, ashtu që urdhrin përmbartimor ta vërtetojë.

Gjykata, pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe deklarimeve të kreditorit në përgjigje ndaj prapësimin, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është i pabazuar për shkaket si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nën-par.1.3 të këtij neni fatura përcaktohet si një nga dokumentet e besueshme, kurse me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbartim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar”*, dhe me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbartim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se Fatura nr. 013/23, e datës 15.06.2023 mbi bazën e të cilës është lejuar përmbartimi, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në faturë janë

treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturës, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi. Po ashtu, fatura i është bashkangjitur propozimit për përmbarim në origjinal, në përputhje me nenin 37 të LPP-së.

Tutje gjykata konstatoi se fatura e lartcekur është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, fakt ky që vërtetohet nga nënshkrimi i debitorit në faturë si dhe nga vula e pranimi të shkresave të debitorit. Për më tepër, pranimi i detyrimit që buron nga fatura e lartcekur nuk është kontestues as për vet palën debitore, fakt ky që vërtetohet edhe nga procesverbali mbi pranimin e punimeve dhe konfirmimi mbi realizimin e pagesës nr. 013/2023 i datës 15.06.2023 të lëshuara nga vet zyrtarët e debitorit, ku konfirmohen punimet e kryera dhe arritshmëria e faturës objekt i këtij përmbarimi.

Gjykata pati parasysh pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim mirëpo gjeti se i njëjti nuk ka ofruar asnjë provë në kuptim të nenit 69.4 të LPP-së për të vërtetuar ekzistimin e një prej shkaqeve të parashikuara me nenin 71 të LPP-së mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur kreditorit shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €, siç është e përcaktuar me Rregulloren e OAK-së e datës 18.03.2017 nr. tariferor gjashtë (6), lidhur me parashitjet për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm me vlerë 10.000,00 € e më lartë.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr. 1233/23, datë 22.02.2024

Gjyqtari  
Florent Zeqiri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.